



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 19 .02. 2026

VENDIM

Nr. 04 Datë 19 /02/2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHES

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Mwrkurw , më datë 25.02.2026, **ora 12:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e radhës së Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

- 1. Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
- 2. Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 29.01.2026.
- 3.** Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
- 4. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Janar 2026.
- 5. Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 12 ha dhe 2200 metra , e ndodhur në njësinë administrative Bucimas që mund të jepen me qira.
- 6. Projekt – Vendim:** Një ndryshim në vendimin nr.130, datë 22.12.2025 “Mbi miatimin me bursë të nxënësve të arsimit të mesëm professional për vitin shkollor 2025-2026”

7. **Projekt – Vendim:** Miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qerasë dhe të nivelit të qerasë mesatare në tregun e lirë në Bashkinë Pogradec .
8. **Projekt – Vendim:** “Miratimin e cmimit maksimal ditor për shfrytëzimin e setit cadër plazhi+ 2 shezlog, në plazhin e Bashkisë Pogradec nga subjektet private që ushtrojnë veprimtari si stacione plazhi”.
9. **Projekt – Vendim:**Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Pogradecit.
- 10.**Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihmë financiare për volejbollisten Znjsh.Laura Mehmeti.
11. **Projekt – Vendim:** Për procedurën e realizimit të shpronësimit të pasurive që preken nga realizimi I projektit të sistemimit të rrugës te blloku, “ Përroi I Caprazit” , për interes publik” .
- 12.**Projekt – Vendim:** Miratimin e tarifave të administrimit nga shoqëria Pogradeci Invest Shpk, të ndërtesave ne bashkëpronësi, për vitin 2026.
- 13.**Projekt – Vendim:**Miratimin e tarifave të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk, për vitin 2026
14. Raportim në Këshillin e Bashkisë për aktivitetin e Shoqërisë Pogradeci Invest Shpk në lidhje me punën e shoqërisë që nga momenti I krijimit deri tani, sfidat dhe planet për të ardhmen.
15. Të tjera.

Ngarkohet Sekretarja e Këshillit , në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale,lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për cdo këshilltar, te kryetari I Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari I Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

